



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS/VLADA KOSOVA/GOVERNMENT OF KOSOVA
MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT
AGJENCIA SHTETËRORE E ARKIVAVE TË KOSOVËS
DRŽAVNA AGENCIJA ARHIVA KOSOVA
THE STATE AGENCY OF KOSOVO ARCHIVES



Nr: 07/2026

Datë: 28.01.2026

Duke marrë parasysh nenin 12, 22 dhe 23 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura (Gazeta Zyrtare, Nr. 7/01 mars 2019), në pajtim të nenit 25 të Ligjit nr. 08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit si dhe në pajtim me nenin 5 (paragrafi 3) të Ligjit Nr. 08/L-111 për Arkivat (Gazeta Zyrtare Nr. 30/5 shtator 2022), U.D. Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë Shtetërore të Arkivave të Kosovës, z. Bekim Aliu, më 28/01/2026, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet përditësimi i Planit të Integritetit 2024–2026 të Agjencisë Shtetërore të Arkivave të Kosovës, përkatësisht për vitin 2026.
2. Zbatimi i Planit të Integritetit për vitin 2026 si në pikën një (1) monitorohet në mënyrë të vazhdueshme nga zyrtari përgjegjës për monitorim, në bashkërendim me strukturat përkatëse brenda institucionit.
3. Monitorimi dhe vlerësimi bëhen edhe në përputhje me kërkesat dhe mbikëqyrjen metodologjike të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit.
4. Ky Vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

A R S Y E T I M

Përditësimi i Planit të Integritetit për vitin 2026 është ndërmarrë pas vlerësimit të zbatimit të Planit të Integritetit 2024–2026 në Agjencinë Shtetërore të Arkivave të Kosovës. Nga ky vlerësim është konstatuar se pjesa më e madhe e aktiviteteve të planifikuara janë realizuar me progres të kënaqshëm, ndërsa disa masa mbeten ende në proces zbatimi dhe kërkojnë rishikim, qartësim dhe përshtatje sipas gjendjes aktuale.

Gjithashtu, gjatë periudhës së zbatimit janë evidentuar ndryshime në rrethanat institucionale, përfshirë ndryshime në strukturën organizative dhe në udhëheqjen e institucionit, të cilat ndikojnë në rolet, përgjegjësitë dhe mekanizmat e kontrollit të brendshëm. Në këtë kontekst, janë marrë parasysh edhe rekomandimet dhe udhëzimet e Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit (APK), me qëllim që masat parandaluese të jenë të zbatueshme, të matshme dhe në harmoni me kërkesat metodologjike.

Përditësimi është bërë në përputhje me Metodologjinë për Hartimin dhe Zbatimin e Planit të Integritetit dhe synon forcimin e integritetit institucional, rritjen e transparencës dhe llogaridhënies, si dhe uljen e rreziqeve të korrupsionit në proceset dhe funksionet kryesore të institucionit.

Bazuar në sa më sipër, u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- Anëtarëve të Grupit Punues;
- Personit përgjegjës për monitorim të Planit të Integritetit;
- Arkivit të ASHAK;
- Drejtorëve të Departamenteve të ASHAK;
- Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit



U.D. Drejtor Ekzekutiv